

Termet e Referencës

Ekspert/e për të realizuar një hulumtim me QPS (Qendra për Punë Sociale)

I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights-H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

III. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS kërkon të angazhojë një ekspert/e për të realizuar një hulumtim rreth kapaciteteve të Qendrave për Punë Sociale (QPS) në ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse për fëmijët, me fokus tek qasshmëria, cilësia dhe disponueshmëria e shërbimeve ekzistuese, për fëmijët me aftësi të kufizuara. Ky hulumtim do të realizohet në QPS-të e komunave Prishtinë, Pejë dhe Gjiilan, dhe do të shërbejë si bazë për të identifikuar nevojat, sfidat dhe mundësitë për përmirësimin e shërbimeve ekzistuese, në mënyrë që ato t’i përgjigjen më mirë nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Qëllimet e hulumtimit janë:

1. Të vlerësohet gjendja aktuale e shërbimeve që ofrohen nga QPS-të e targetuara, me qëllim të kuptimit të qasshmërisë, cilësisë dhe disponueshmërisë së këtyre shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.
2. Të identifikohen boshllëqet në njohuri profesionale, kapacitete njerëzore dhe financiare, si dhe në mekanizmat e monitorimit, kontrollit të cilësisë dhe koordinimit ndërinstitucional, që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve që marrin fëmijët me aftësi të kufizuara.
3. Të hartohen rekomandime konkrete dhe të zbatueshme për adresimin e sfidave të identikuara dhe për fuqizimin e QPS-ve në ofrimin e shërbimeve të qasshme, cilësore dhe të ndjeshme ndaj nevojave të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

4. Të ndahen gjetjet dhe rekomandimet me institucionet përkatëse, organizatat e shoqërisë civile dhe palët e tjera të interesit, me qëllim të informimit, ndërgjegjësimit dhe avokimit për përmirësime të mëtejshme në ofrimin e shërbimeve.

2. KUALIFIKIMI

- Diplomë universitare në shkenca sociale ose fusha të ngjashme;
- Përvojë në hulumtime cilësore dhe përvojë me fushën e aftësisë së kufizuar;
- Njohuri mbi sistemin e mbrojtjes së fëmijëve dhe shërbimeve sociale dhe familjare;
- Njohuri mbi funksionimin e QPS-ve;
- Njohuri për standardet dhe kornizën ligjore të mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë;
- Aftësi të shkëlqyera analitike, hartimi raportesh dhe prezantimi.

3. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja i/e angazhuar do të jetë përgjegjës/e për:

- Analizimin e dokumentacionit ekzistues, përfshirë kornizën ligjore, standardet e shërbimeve sociale, raportet e mëparshme dhe të dhënat relevante mbi funksionimin e Qendrave për Punë Sociale dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara. Përcaktimi i metodologjisë së hulumtimit; përfshirë identifikimin/zhvillimin e instrumenteve për mbledhjen e të dhënave, përcaktimin e mostrës së hulumtimit, si dhe planifikimin e procesit të mbledhjes dhe analizës së tyre.
- Mbledhja dhe analizimi i të dhënave sipas përcaktimit të metodologjisë, nga Qendrat për Punë Sociale të targetuara në këtë hulumtim.
- Koordinimin e ngushtë me Qendrat për Punë Sociale në komunat e targetuara, dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm me ekipin e HANDIKOS gjatë gjithë procesit të hulumtimit.
- Hartimin e raportit përfundimtar në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke përfshirë analizat kryesore dhe rekomandime konkrete e të zbatueshme për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara nga QPS-të.

4. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Korrik 2025 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Analizimi i korgjinës ligjore dhe standardeve relevante për shërbimet që ofrohen	1 ditë
Përcaktimi i metodologjisë së hulumtimit	1 ditë

Zhvillimi i instrumenteve për mbledhjen e të dhënave dhe mënyra e mbledhjes së tyre	3 ditë
Mbledhja dhe transkriptimi i të dhënave	4 ditë
Hartimi i raportit në gjuhë të thjeshtë duke përfshirë draftimin e rekomandimeve	3 ditë
Total	12 ditë

5. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo. Pagesa do të bëhet pas përfundimit dhe dorëzimit të dokumentit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

6. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim (max. 3 faqe);
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org

cc: nora.simitciu@handi-kos.org dhe antika.maksutaj@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për “Ekspert i hulumtimit rreth kapaciteteve të QPS (Qendrave për Punë Sociale) për shërbime gjithëpërfshirëse për fëmijët”.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 11 Gusht 2025.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.